

KOMPANIA REJSIONALE E MBETURINAVE
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA
"ÇABRATI" SH.A. JSC.DD.
GJAKOVË
Nr.No.Br. 854 Shtese 1
Dt. 25.04.2024



Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike Neni 22, paragrafi 2 dhe 3, Ligjit Nr. 04/L060 për Mbeturina dhe Rregullores Komunale për Menaxhim të Mbeturinave në Territorin e Komunës së Gjakovës me nr. prot. 01/11196 e datës 06.05.2021, nenit 5 të Ligjit Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 08/L-063 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Racionalizimin dhe Vendosijen e Vijave Llogaridhëse të Agjencive të Pavarura, nenit 23 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale dhe Kompania Regjionale e Mbeturinave "Çabрати" Sh.A me datë. 25.04.2024 lidhin këtë:

MARRËVESHJE

PËR SHËRBIMIN E GRUMBULLIMIT DHE TRANSPORTIMIT TË MBETURINAVE NË KOMPLEKSIN MEMORIAL "BETEJA E KOSHARES" NË KOSHARE DHE KOMPLEKSIN MEMORIAL "27 PRILLI" NË MEJE, GJAKOVË

Përmes kësaj marrëveshje:

Neni 1

1. Agjencia për Menaxhimin e Monumenteve dhe Komplekseve Memoriale, rr. "Zenel Salihu" p.n., ish Gjykata Themelore Prishtinë Kati III, i përfaqësuar nga: **z. Imer Hakaj**, Drejtor Ekzekutiv i AMMKM-së
dhe
2. Kompania Regjionale e Mbeturinave K.R.M. "Çabрати" Sh.A., rr. "Mazllom Lakuci" pn. Gjakovë, me nr. unik identifikues 811299165, të cilën e përfaqëson **z. Behar Ferizi**, Kryeshf Ekzekutiv;

Bien dakord që K.R.M. "Çabрати" Sh.A., të ofroj shërbimin e grumbullimit (zbrazen e kontejnerëve) dhe transportimit të mbeturinave nga Kompleksi Memorial "Beteja e Koshares", Koshare dhe Kompleksi Memorial "27 Prilli" - Mejë, deri në deponinë sanitare.

Neni 2

K.R.M. "Çabрати" Sh.A., obligohet që të bëjë furnizimin e hapësirave në Kompleksin Memorial në Koshare me 2 kontejnerë 1.1m3 dhe 5 kontejnerë 240L. Ndërsa me 2 kontejnerë me 1.1m3 në kompleksin memorial në Mejë.

Neni 3

Zbrazja e kontejnerëve në Kompleksin Memorial në Koshare, do të bëhet sipas planit të paraparë nga Kompania, dy (2) herë brenda muajit, ndërsa në Kompleksin Memorial në Mejë çdo javë dhe në rast të nevojës për shërbim shtesë AMMKM duhet të njoftojë kompaninë një deri dy ditë më herët.

Neni 4

Tarifat për zbrazje të kontejnerëve janë të përcaktuara përmes Vendimit për caktimin e tarifave të shërbimit të grumbullimit të mbeturinave 01 Nr. 011/01-18668/ 2020 i datës 26.08.2020, andaj vlera e faturës mujore për zbrazje të kontejnerëve si në pikën 2 dhe 3 të kësaj marrëveshje do të llogaritet sipas listës përcjellëse, ku vlera për zbrazjen e një kontejneri me vëllim 1.1m3 është 12.20 Euro ndërsa vlera për zbrazjen e një kontejneri me vëllim 240L është 2.50 Euro.

Neni 5

Faturat mujore për shërbimin e ofruar përgatiten nga data 01 - 05 të muajit përkatës dhe të njëjtat dorëzohen përmes postës në adresën e AMMKM, kurse pagesa e shërbimeve kryhet pas pranimit të faturave përmes llogarisë bankare.


Neni 6


Palët obligohen që së bashku të përmbushin detyrat e precizuara në nenet paraprake me korrektësi të plotë dhe pa pengesa ligjore, në të kundërtën mosmarrëveshjet eventuale që paraqiten gjatë zbatimit të kësaj marrëveshje, kërkohet që zgjidhja të bëhet përmes dialogut dhe mirëkuptimit. Po që se një gjë e tillë nuk arrihet, kontesti do të zgjidhet në gjykatën kompetente.

Neni 7


Pas njoftimit me përmbajtjen e marrëveshjes, e njëjta u nënshkrua nga palët kontraktuese, me datë 25.04.2024 në Gjakovë, në 4 (katër) kopje të njëjta, prej të cilave dy për AMMKM dhe dy për K.R.M. "Çabрати" Sh.A.

Z. Imer Hakaj,


Drejtor Ekzekutiv në
Agjencinë për Agjencinë
Menaxhimin e Monumenteve dhe
Komplekseve Memoriale



Z. Behar Ferizi,


Kryeshef Ekzekutiv në
Kompania Regjionale e Mbeturinave
"Çabрати" Sh.A.

